



VENDIM

Nr.61 Datë 23.04.2015

PËR

FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË “PËRPARIMI SK” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”; 9 dhe 13 pika 1, gërma “d” të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “g”; 5 pika 1 gërma “g”; 8 dhe 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 23.04.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “PËRPARIMI SK” sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “PËRPARIMI SK” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave” si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

Neni 9, pika 1- Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9,pika 2-Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është i plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 3 -Dokumentacioni finaciar dhe fiskal është i plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4/10, gërma “a” Sasia e energjisë elektrike e parashikuar plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4/10, gërma b-kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e aktivitetit plotësuar në mënyre korrekte.

Neni 9, pika 4/10, gërma c- plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për licensimin e shoqërisë **“PËRPARIMI SK”** shpk, në aktivitetin e Tregimit të Energjisë Elektrike
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI i ERE-s

Petrit AHMETI